

PROCESVERBAL V /2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 5 (pestë) për vitin 2025 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi:	Suharekë
Zyra:	Salla e Kuvendit të Komunës
Data:	30.05.2025
Ora:	10:00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci
Z.Selman Kolgeci
Z. Flamur Bytyçi
Z. Urim Suka
Z. Kushtrim Kuçi
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj.Doruntina Zenelaj
Z.Alban Berisha
Z. Bexhet Kuçi
Z. Reshat Selimaj
Z. Lirim Qatani
Z. Aziz Bytyqi
Znj.Sanie Kuçi-
Rexhepaj
Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina
Z. Vullnet Luzhnica
Z. Xhevshet Gashi
Z.Edon Sadikaj
Znj.Saranda
Bajraktari
Znj.Mimoza Bajraktari
Znj.Festë Kabashi
Z.Dardan Berisha
Z.Bajram Basha
Znj.Mevlude Kabashi
Znj.Sheqerije Zyrapi
Znj.Laureta Tafaj
Z.Liridon Fandaj
Z.Qëndrim Elshani
Z.Herolind Limaj
Znj.Jehona Lumi
Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për bonuset e zonimit për Komunën e Suhrekës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e vlerës së bonus banimit;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve „Emblema e Artë“, „Skënderbeu“ dhe mirënjohjen „13 Qershori“.**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-18942;**
- 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës 01-Nr-553-27510;**
- 8. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - ia jep fjalën Selman Kolgeci.

Selman Kolgeci - përshëndet të pranishmit.Kemi kërkesë për një pikë shtesë në rend dite e cila ka të bëjë me miratimin e vendimit për lirim nga pagesa për gjithë shërbimet shëndetësore publike në institucionet shëndetësore nën menaxhimin e Komunës së Suharekës për pjestarët e policisë së Kosovës, pjestarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe familjes së tyre të ngushtë me vendbanim në Suharekë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shtesë të propozuar nga Selman Kolgeci.

Unanimisht Miratohet

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

Unanimisht Miratohet

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2.Shqyrtimi i projekt-Rregullores për bonuset e zonimit për Komunën e Suhrekës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Flamur Bytyçi - Përshëndet të pranishmit.Në parim jam kundër kësaj rregullore por nuk e kam të qartë se pse duhet me i dhënë kompetencë Kryetarit të Komunës me vendos edhe për komisionin dhe për kërkesa.Gjithëashtu nuk e kam të qartë që Kryetari themelon komision të përhershëm dhe atëhok dhe pse duhet me qenë vetëm përfaqësues të ekzekutivit dhe mos me pas Kuvendi komunal anëtar të këtij komisioni.Kërkoj sqarim prej zyrtarit ligjor.

Avni Bytyqi - Përshëndet të pranishmit.Në këtë grup punues kam qenë edhe unë dhe ne kemi realizu dhe

e kemi diskutu çështjen e formimit të komisionit.Çështja e komisionit me mandat apo të përhershëm,apo komisionit atëhok e kemi shqyrtu dhe kemi bërë kërkesë që në kuadër të kësaj rregullore të jetë mundësia që kur do herë zyrtarët dhe komisioni që themelohet i përhershëm ka ngarkesë që nuk mund ti përballoj të gjitha lëndët për t'i shqyrtuar dhe për t'i rekomanduar Kryetarit për aprovim apo ndonjë rast specifik që kërkohet të trajtohet,atëherë i jepet manadat dhe kompetencë Kryetarit të komunës që ta themeloj edhe një komision atëhok që t'ju del në ndihmë komisionit të përhershëm.

Flamur Bytyçi - ju bëj thirrje edhe kolegëve që mos ta votojmë për shkak se ne si Asamble nuk kemi asnjë përfaqësues.Edhe Kuvendi duhet ti ketë dy ose tre anëtar në këtë komision sikurse në komisionet tjera.

Mevlud Kabashi - Përsëritet të pranishmit.Nga ajo që lexova dhe kuptova,bonuset e zonimit nuk i pash si diçka të dobishme për qytetarët por thjesht si një lloj ndërtimi me pazar.Unë personalisht jam kundër këtij projekti.

Selman Kolgeci - dua një shpjegim të qartë nga Drejtori i Urbanizmit.Sa banorë janë planifiku me m'brri qytetin në vitin 2030 kur përfundon edhe afati i kësaj HZK-je dhe sa shtohen përmes kësaj rregullore ?

Më jep përshtypjen që ky dokument po përdoret për qëllime elektorale por edhe për vërejtjet që do të japim më poshtë.Shprehim kundërshtimin tonë të qartë ndaj miratimit të kësaj rregullore për bonuset e zonimit e cila sipas vlerësimit tonë rrit koncentrimin e fuqisë vendimmarrëse të Kryetarit duke anashkaluar Kuvendin.Ne kemi çdo ditë ulje të numrit të qytetarëve rezidentë në komunën tonë dhe për këtë siç jemi njoftuar,tani legjislatura e ardhshme e Kuvendit Komunal do të ketë 4 anëtar më pak dhe ju po insistoni me rrit etazhitetin përmes kësaj rregullore në devijime të caktuara që janë në shërbim të grupeve të ngushta të interesit.P.sh. vetëm prej periudhës kur është miratu udhëzimi administrativ mbi normat teknike të planifikimit hapësinor, pra viti 2017,dhe sot në krahasim me vitin 2017 Suhareka ka 24% më pak banorë dhe ju këtë rregullore po tentoni që nga koeficienti 3 me bërë koeficientin 5.Po e rritni për 66% ndërtimin në disa parcela. Te pika 5.2 Zvogëlimin e kërkesave për tërheqjen e vijës së ndërtimit mund të tolerohet deri në 10% të asaj çfarë është përcaktuar në HZK të Komunës së Suharekës e cila kalkullohet duke qenë e varur nga përqindja e sipërfaqës që i merret për respektimin e vijës rregullative sipas HZK-së.Vija ndërtimore nuk ka kuptim m'u luft për shkak të bonuseve.Kriteret tjera teknike duhet të parashihen në HZK por kjo formë që është potencu këtu nuk ka kuptim. Pika 5.6 Rritja e lartësisë së kateve maksimale të ndërtesës investitorit mund ti lejohet jo më shumë se 10% e lartësisë maksimale të përcaktuar me HZK.Kjo rritje nuk ka kuptim në përqindje,mund të ketë kuptimin kalkulimi deri në 5 kate,p.sh me ia dhënë 1 kat ndërtimi dhe mbi 5 kate me ia dhënë 1 kat.Nuk e kam të qartë si me rrit 1.5 m lartësia nëse themi 10% objekti! sepse nuk ka kuptim m'u rrit 1.5 % lartësia e një objekti.Pika 7. Kryetari i Komunës mund të themelojë komision të përhershëm për shqyrtimin e kërkesave për bonuse të zonimit por mundet edhe komisione atëhok.Rregullorja i jep diskresion të plotë Kryetarit të komunës për të themeluar komision dhe për të lidhur marrëveshje për bonuset pa përfshirjen e Kuvendit si organ mbikqyrës.Kjo e centralizon vendimmarrjen në nivel ekzekutiv duke anashkaluar kontrollin demokratik dhe transparencën institucionale.Kjo mendoj që bie ndesh edhe me parimin e ndarjes së pushteteve dhe cenon kontrollin demokratik institucional brenda vetqeverisjes lokale.Trajtimin e lëndëve të tilla,ashtu siç është aludu në këto nene mundet me realizu një kolegjum për Planifikim Hapsinor që duhet m'u emëru prej Kuvendit ose nëse nuk ka kapacitet ai komision, mund ta bësh një komision të dytë të përhershëm por jo të bëhen komisione atëhoke sepse nuk i shërbejnë ndërtimit të qytetit.Mendoj që këtë rregullore duhet mos me kalu dhe i bëj thirrje të gjithëve mos me kalu.

Liridon Fandaj - këtë pikë e kemi diskutu edhe në KPF dhe drejtori atë ditë është zotu që do të vijë me sqarime shtesë.Atë ditë unë i kam ngrit shqetësimet që ky proces nuk ka qenë gjithëpërfshirës dhe është jo transparent.Për deri sa neve na vje në Asamble me votu,ne si të zgjedhur të qytetarëve do të duhej ta kishim më herët si draft dhe ti jepnim vërejtjet.Po ashtu edhe njoftimi publik ka qenë shumë i shkurt,15 ditë dhe njoftimi ka qenë vetëm në faqe të Komunës.Ne jemi kundër kësaj projekt-rregullore dhe kërkojmë të tërhiqet dhe të rishikohet prap.

Urim Suka - Përsëritet të pranishmit.Në parim edhe ne si LDK kur kanë ardhë rregullore,projekt-rregullore që duhet komuna ti ketë në shumicën e rasteve,e kemi dhënë pëlqimin tonë që ato dokumente të hartohen.Një rregullore e tillë e cila është duke ndodh për herë të parë,unë pata kërku në KPF që për

Asamble me na ardhë një sqarim më në detaje që ne me ditë kush janë përfituesit nga kjo rregullore, çfarë interesi publik mbron kjo rregullore, dhe nëse arrin me ato prezantime me u pa që diçka është e mirë, ndoshta edhe do të kishim një mendim të qartë për votën për apo kundër. Duke iu bashku edhe shqetësimeve që i ngritën asambleistat tonë, ne e kemi qëndrimin që kjo rregullore do kohë dhe nuk duhet të bëhet tash edhe për shkak që jemi afër zgjedhjeve dhe mund të ketë qëllim elektorale. Si e tillë unë kërkoj me mirëkuptim që kjo rregullore të tërhiqet dhe në Asamblesë të ardhshme le të jetë, le të rregullohet dhe të hyjë në fuqi. Vota jonë është kundër kësaj rregullore për sot.

Dardan Berisha - Përsëritet të pranishmit. Duke marrë parasysh që HZK për periudhën 2022-2028 ka përcaktuar kriterin prej 1.200 m² si ipërfaqe minimale për ndërtimin ndërtesa të veçanta për zonën ZB4, si e arsyeton drejtoria faktin që ky kufizim po i përjashton shumë pronar të ligjshëm të cilët posedojnë parcela më të vogla? si në rastin konkret kur një parcelë prej 525 m² me qasje të rregullt brenda zonës së banimit dhe që përmbush të gjitha kriteret dhe kushtet teknike për ndërtim. A ka komuna ndonjë mekanizëm të mundshëm për rishqyrtim, prejashtimin individual apo proces fleksibilizimin në rastet e veçanta ku qytetarët nuk kanë mundësi bashkimi të parcellës dhe kanë mbetur të bllokuar ndaj një kriteri që nuk ishte në fuqi më parë?

Visar Kuçi - HZK-ja, PZHK-ja dhe kjo rregullore iu kanë nënshtruar të gjitha normave teknike të planifikimit hapsinor. Një prej pikave që është e paraparë edhe në këtë rregullorë, është pjesa e parcelës minimale që në disa raste duhet të bëjë prejashtime ku duhet të zvogëlohet parcela minimale. Në pjesët ku janë parcellat minimale zakonisht pronarët e tokave ose investitorët mund të japin pëlqim ose ti bashkojnë parcellat dhe e mbërrijnë sipërfaqen minimale. Kjo rregullore i ka ndjek të gjitha procedurat ligjore dhe me vendim të Kryetarit të Komunës është formuar komisioni. Pjesëmarrës në komision kanë qenë të gjitha drejtoritë sektoriale dhe drejtoia e Urbanizmit ka qenë bartëse e kësaj rregullore. Sa i përket procedurave që nuk ka marrë pjesë asnjë asambleist besoj që juristat e dinë më mirë që është brenda ligjit. Ne kemi miratuar edhe rregullore tjera pa pjesëmarrje të Asamblesë. Sa i përket shtimit të numrit të banorëve, nuk do të thotë që ka me u rrit koeficienti bazë i kësaj rregullore, me shku në koeficientin 5 në gjithë qytetin, aty do të bëhet një zgjidhje i atij blloku ose i saj parcellë. Sa i përket komisionit atëherë, kjo bëhet vetëm për rastet që janë më të komplikuar. Është e përcaktuar me HZK që komuna duhet ta hartojë një rregullore të bonuseve. Ju lus ta votoni këtë rregullore dhe ta bëjmë një zgjidhje për qytetin tonë, qytetarët dhe investitorët tonë. Sa i përket katshmërisë, është e cekur dhe në HZK që lartësia maksimale në ZSHP5 ose ZB4 është 28 m dhe kjo lartësi e arrinë përdheshën + 8 kat por mund të ja rrisim edhe katin e tërhequr.

Flamur Bytyçi - mua më duket që Kryetarit i jepet pushtet absolut me këtë rregullore. Nuk e kuptoj që pse unë duhet me votu një diçka që s'jam pjesë e saj. Mund ta ndryshosh këtë rregullore dhe në komision me fut edhe anëtar të Kuvendit.

Visar Kuçi - komisioni nuk ka me qenë për çdo lëndë i formuar. Me vendim të Kryetarit bëhet një komision ku kanë me qenë ekspertat e lirisë dhe nuk ka me qenë dikush që nuk e kupton këtë lami. Kanë me qenë 3 anëtar të komisionit, një nga Drejtoria e Financave, një nga Drejtoria e Pronës dhe një nga Drejtoria e Urbanizmit, kryesisht të planifikimit.

Flamur Bytyçi - unë të kuptoj por ka raste kur bëhet këmbimi i pronës dhe në komisione janë 2-3 përfaqësues të ekzekutivit por janë dhe 2-3 të Kuvendit dhe nuk janë gjithë asambleistat ekspertë të fushës.

Visar Kuçi - Drejtori jep sqarime.

Avni Bytyqi - e thashë dhe më herët që janë dy pushtete të ndara, legjislativi dhe ekzekutivi. Ju jeni organ i cili miraton ligjet, Kryetari dhe ekzekutivi ka për obligim të ekzekutojë vendimet dhe rregulloret ashtu siq miratohen në Kuvend nëse edhe ai vlerëson që është në rregull, sepse konkretisht neni 58 i jep kompetencë dhe mandat Kryetarit që para se të hyjë në fuqi një akt që miratohet në Kuvend, ta kthejë në rishqyrtim nëse vlerëson që nuk është në harmoni dhe në përpuetshmëri me ligjet. Në këtë rast unë sëbashku me grupin punues kemi vlerësuar që nuk ka nevojë të jenë anëtar të Asamblesë në komision për të vetmen arsye ku e shihni edhe ju vet që kur po e japim pronën në shfrytëzim çfarë procedura të komplikuar janë, ku po duhet 3 ose 4 muaj me prit një vlerësim të ligjshmërisë të një komisioni dhe ka kërkesa të tilla në komunë që duhet të trajtohen shpejt dhe në mënyrë specifike. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime dhe thotë që legjislativi e ka mundësinë dhe përgjegjësinë e monitorimit të procesit dhe kërkesës së llogaridhënies së ekzekutivit në raport me këtë zbatim të kësaj rregullore.

Flamur Bytyçi - unë mendoj që këtë rregullore ka me kthi prap ministria.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

13 për,15 kundër,1 apstenim, Nuk Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - sot dua të shpreh shqetësimin tim lidhur me raportin e vlerësimit të pronës komunale të datës 02.03.2025 i cili rekomandon dhënien e pronës përmes konkurimit të hapur me përfitim me 21 % të Komunës. Ky rekomandim bie ndesh me disa parime themelore që ne si përfaqësues të qytetarëve kemi për obligim ti mbrojmë. Vetëm disa muaj më parë komuna jonë ka nënshkruar marrëveshje me investitorë tjerë me të cilën përfitimi i komunës është 27% .Nuk është e pranueshme që për prona publike në kushte të ngjashme të përdoren dy standarte të ndryshme dhe kjo i bie që dikënd e favorizojmë dhe dikënd e ndëshkojmë. Ne para disa muajve e kemi bërë me 27 % dhe kjo po bie ndesh me atë që ne kemi votu më herët. Kërkoj që ky rekomandim të tërhiqet dhe të korigjohet që mos të dëmtohet prona publike.

Armend Krasniqi - komisione të cilat formohen në Asamble kanë kompetenca për vendosjen e kriterëve bazë. Çdo thirrje që e kemi bërë paraprakisht kriteri bazë ka qenë për vendosjen e 20% të kriterit për dhënie në shfrytëzim. Edhe thirrjen paraprake kur e kemi dhënë me 27%, thirrja ka qenë 20 % kriteri minimal mirëpo ofertuesi ka ofru 27% ndërsa në thirrjen tonë të cilën e kemi publikuar, përveq kriterëve tjerë të cilat i ka plotësuar ofertuesi dhe kriterin e vlerës min. të cilën e kemi caktuar ne, ai e ka tejkaluar dhe e ka vendos 21 dhe nuk është asgjë kundërligjshëm, dhe për këtë ju rekomandoj që kjo është një gjë shumë e rëndësishme sepse përfiton komuna si asnjëherë më parë dhe është e domosdoshme që të votohet pro dhe të ndihmohet qytetari i komunës së Suharekës dhe po ashtu edhe bizneset të cilat janë duke ndërtuar.

Liridon Fandaj - kur e thua që komuna përfiton si asnjëherë më parë, nuk e di a është 27% më i madh se 21%! Nuk po e rriti në kat si e ke mendu ti por të them që 27% është më i madh se 21%. Sikur prona të ishte afatshkurtër, do t'ju mbetej barrë juve si komision por kjo është afatgjatë dhe barra kryesore është mbi ne si Asamble. Nëse ne vendosim sot me dëmtu interesin publik para atij privat, e ke gabim drejtor.

Armend Krasniqi - Drejtoria e Pronës i ka ndihmu jashtëzakonisht shumë qytetit të Suharekës në zhvillimin e qytetit por kriteret të cilat i vendos një komision që formohet në Asamble, ka kompetencë të plotë për përpilimin e pikave për ta shpallur konkurimin e hapur. Ne si komision kemi konstatuar që kjo procedurë më shumë se sa e rregullt, i ndihmon qytetarët dhe patjetër duhet të inicohet. Mirëpo ofertues ka qenë fatkeqësisht vetëm një dhe në kuadër të asaj oferte ka qenë ofreta më e mirë e kompletuar me të gjitha dokumentet të cilat i ka kërkuar ky komision. Drejtori tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - në bazë të cilave dokumente keni vendos me dhënë me 21%? Përfaqësues të vetvendosjes nuk kemi ne në atë komision.

Armend Krasniqi - P.sh. ne kemi caktuar thirrje për lokale dhe 5 € ka qenë m² në rregullore por ofertuesi ka ofru 15 € në m² për lokale. Pra në konkurim të hapur kush e jep çmimin më të lartë, ai e fiton dhe këtu e kemi pas vetëm një konkures i cili ka qenë i përgjegjshëm.

Visar Kuçi - komuna në këtë rast kishte m'u dëmtu nëse pragu aktual komisioni e ka vendos 20% dhe ofertuesi aplikon me 19% përndryshe komisioni e ka vendos dhe zakonisht pragu në komunën e Suharekës është 20% dhe nuk mund ti ndalim investitorët dhe mendoj është ligjore. Komisioni është i formuar nga Asambleja, nga të gjitha partitë politike. Sa i përket rregullores që nuk e aprovuat, të gjithë ata që e kanë votu kundër, i kanë dëmtu investitorët, i kanë dëmtu procedurat për marrjen e lejes për ata që aplikojnë në komunën tonë. I ftoj qytetarët që të kenë kujdes kënd e votojnë herave tjera dhe kush i përfaqëson.

Urim Suka - thirrja e fundit që sapo bëri drejtori e sdomos në një formë nëse mund ta quaj linqim apo shantazh për asambleist që kanë votu kundër, është e çuditshme e sidomos që po thotë që lëndët po presin. Kjo po e figjizon atë që ne e kemi votu kundër. Sa i përket pikës që po flasim ,në qoftëse ne nuk e mbrojmë interesin publik këtu, si e kishim mbrojtë me pas qenë për interesin tim privat? Jemi duke gabu.

Përgjegjës është komisioni dhe ekzekutivi dhe ata që janë bartës të këtyre proceseve. Mos mundohi me lënë fajin te një anëtar i një partie politike. Ky komision na ka sjell një vlerësim me 21% që përfiton komuna e në fakt krejt e dimë që në teren shkon me 27%, 28,30 e 33%. Pse atë pragun minimal e keni lënë 20% për deri sa tregu po thotë 30%? Pse nuk e keni lënë me 27% pragun që ai mos me mujt me marrë?

Duke e marrë për bazë këtë raport dhe duke e ditë tregun çka po ndodh, po besojmë që nuk po mbrohet interesi publik aq sa është realja, andaj vendimi jonë është kundër. Shqetësim tjetër është që unë kalova andej dhe pashë plot reklama të Imoland. A ka fillu ndërtimi aty? A ka leje ai për me bë ndërtim? Nëse ka fillu ndërtimi, mos na sillni letra me vendos për diçka që keni fillu dhe nëse s'ka fillu, mos i leni.

Armend Krasniqi - faktikisht LDK e ka pas përfaqësuesin më serioz dhe më kompetent se gjithë tjerët sepse merr vesh nga çështjet e këtyre ndërtimeve andaj i deleguari juaj e ka propozu që të startojmë me 20% dhe ka shku me 20%. Nuk e di pse po e kundërshton veten.

Urim Suka - jo i deleguari i LDK-së por unë personalisht nëse e kisha bërë një propozim të tillë, edhe nëse sot e shoh që interesi publik qenka me 33%, edhe kundër vetes kisha dal.

Alban Berisha - te neni 4 i vendimit që prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin, nëse kjo vlen për këto 99 vite dhe aty e dimë që do të ndërtohen banesa dhe lokale dhe normal personat fizik ose juridik kanë me ble prona, mos po i penalizon ky nen që mos me pas të drejtë me ia shit?

Armend Krasniqi - e kemi pronën komunale që ka me u dhënë në shfrytëzim deri në 99 vite mirëpo ai në pronën komunale ka me ndërtu një objekt dhe këtë e lejojnë ligjet në fuqi të cilat i kemi dhe kemi vepru në bazë të ligjit dhe nuk e suspendon nga shitja.

Avni Bytyqi - ligji për dhënie në shfrytëzim i jep kompetencë dhe autoritet komunës që të jep në shfrytëzim pronën publike por asnjë kompetencë dhe asnjë mandat nuk e jep që ta shet pronën e komunës, ta tjetëron, ta bartë tek një person tjetër. Asnjë dispozitë ligjore e asnjë ligji të aplikueshëm në RKS nuk e lejon një gjë të tillë. Të gjithë Investitorët që kanë marrë pronën në shfrytëzim për 99 vite janë të vetëdijshëm që prona nuk bartet në emër të tyre asnjëherë dhe pronar mbetet komuna e Suharekës çdoherë.

Alban Berisha - a kanë me u ndërtu shembull 100 banesa dhe a duhet me i shit ai pronari?

Avni Bytyqi - mund ti shet. Ai e blen objektin ndërsa prona mbetet çdo herë e komunës.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

16 për, 13 kundër, Miratohet pika 3

Saranda Bajraktari - Kushtrim ti ke qenë pjesë e komisionit dhe nuk po e kuptoj se si vendimi yt profesional bie në kundërshtim me vendimin e partisë. A është e rëndësishme egoja jote dhe profesionalizmi apo çështja e partisë? Nëse brenda partive politike nuk e kemi të drejtën me vendos mbi parimet si janë, atëherë më vje keq shumë për LDK-në.

Urim Suka - në rastin konkret Kushtrimi është në të drejtën e vet me votu për, me apstenu apo me votu kundër. Pas debatit që u bë mendoj që Kushtrimi u pajtu që interesi publik ka mujt në këtë rast me u mbrojt më mirë dhe e ka ndryshu mendimin e vet.

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e vlerës së bonus banimit;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - ky është një vendim që po përcillet në vazhdimësi në vite dhe në gjitha rastet ne si LDK i kemi dhënë mbështetje. Padyshim edhe këtë vit e mbështesim këtë projekt-vendim që ka ardhë por diçka që më habit dhe po bëhet vazhdimisht praktikë është që unë në mbledhjen e KPF-së kam kërku që për mbedhjen e Asamblesë me na ardhë edhe një raport për vitin paraprak se çka ka ndodh me atë vendim që e kemi marrë. Nëse ne do ta kishim një informatë për vendimin që kemi marrë ndoshta do të dinim me gjyku më mirë këtë vendim që po e marrim këtu. P.sh. a ka nevojë 15 apo 20 apo 5 familje. Kërkojmë që mbledhjen e ardhshme të paktën ta kemi raportin për vitin paraprak se çka ka ndodh me bonus banimin.

Kryesuesi - është e vërtetë që e keni kërku raportin por meqenëse nuk është drejtoresha këtu, ju e keni të drejtën me ia kërku edhe në forma tjera.

Liridon Fandaj - I bashkangjitem kërkesës së Urimit për raportin.Ka disa mbledhje që drejtoresha nuk është e pranishme dhe nëse sot është një vendim prej drejtorisë së saj do të duhej t'na jepte sqarime.Edhe ne si grup e mbështesim këtë projekt-vendim dhe në Asambleenë e radhës e kërkojmë raportin.

Dardan Berisha - kemi kërku një raport në KPF me na sjell në seancën e rregullt.Raporti nuk është dhe i bashkohem kësës së Liridonit që drejtoresha nuk është e përgjegjshme ndaj vendimeve të veta që i sjell në seancë.A janë konfidenciale emrat brenda raportit dhe a ka ndonjë listë të pritjes se kush pret,apo shkon bllanko kjo çështje?

Avni Bytyqi - ligji për mbështetjen e financimit për programe të veçanta e specifikon qartë që Kuvendi i komunës ka të drejtë të merr vendim për subvencionimin e rasteve të familjeve me nevoja të veçanat dhe e përcakton maksimumin e financimit,50% dhe lë në kompetencë të Kuvendit të komunës të përcakton edhe numrin e familjeve që përfitojnë.Lista nuk është konfidenciale dhe mund t'ua prezantojmë listën por kuvendi e obligon komunën që për çdo vit që të bën thirrje për familjet të cilat kanë nevojë për ti mbështetur në çështjen e shpenzimeve të qerasë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

Unanimisht Miratohet pika 4

Pika 5.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve „Emblema e Artë“,“Skënderbeu“ dhe mirënjohjen „13 Qershori“.

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Qëndrim Elshani - Përshëndet të pranishmit.Të nderuar të pranishëm,sot para vetes kemi një projekt-vendim që tejkalon dimensionin formal dhe juridik të një akti institucional.Kemi një vendim që lidhet drejtpërdrejtë me vlerat më të larta morale,historike dhe kombëtare të popullit tonë-me luftën për liri,me sakrificën e dëshmorëve dhe kontributin e atyre që e ndërtuan këtë realitet që ne sot e gëzojmë.Shpërblimet që parashihen në këtë vendim nuk janë thjeshtë një formë simbolike e falemnderimit por janë një akt institucional i kujtesës dhe nderimit për individë dhe grupe që lanë gjurmë të pashlyeshme në historinë tonë.Me dhënien e Emblemës së Artë për Avdi R. Berishën(post mortum),ne nuk po e shpërblejmë vetëm një individ por po nderojmë një jetë të tërë të përkushtuar kombit dhe vendlindjes.Shpërblimi “Skënderbeu” për dëshmorin Muhamet Rr. Krasniqi është një dëshmi tjetër se komuna e Suharekës nuk harron bijtë e saj që dhanë jetën për liri.Ndërsa mirënjohja “13 Qershori” për themeluesit e Brigadës 123 të UÇK-së dhe për qytetarë të dalluar të komunës sonë,është një përpjekje për ta institucionalizuar vlersimin e përpjekjeve të përbashkëta të luftës çlirimtare.Të nderuar kolegë,ky vendim është më shumë se një listë emrash.Është një akt përgjegjësie historike,një mesazh për brezat e rinj që liria nuk është dhuratë por rezultat i sakrificave të mëdha. Për këtë arsye,unë e mbështes fuqishëm këtë projekt-vendim dhe ftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit që të votojmë njëzëri për të nderuar jo vetëm individët e përmendur por edhe idealin për të cilin ata kontribuan. Lavdi të rënëve për liri.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-18942;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - këso vendime të shfuqizimeve nga Ministria tash më janë bë praktikë por tash kur unë e analizoj këtë vendim që ka ardhë për shfuqizim,mendja më shkon në dy drejtime.Drejtimi i parë më shkon te ajo video që e kemi pa Kryetarin e komunës duke hip në traktor dhe duke e lëvru arën,e cila është thjesht një propagandë masive dhe asnjë rezultat nuk e sjell për qytetarin dhe e dyta është te aktakuza që është ngrit për 7 zyrtarë komunal.Pra,në njërën anë hargjojmë energji duke e bë gjithë atë propagandë dhe në anën tjetër i detyrojmë në një formë zyrtarët e komunës me bo gabime aty ku e kemi përgjegjësi dhe

kjo është shqetësuese. Nëse nuk është përgjegjësia e Kryetarit siç aktakuza po thotë për ata tjerët, atëherë pse nuk ka marrë masa Kryetari më herët me parandalu para se me ardhë te aktakuza? Përgjegjësia e dimë se te kush është. Sa i përket vendimit që po flasim, gati secilën mbledhje ia kemi thënë drejtorit që ka sponzorizuar vendime të tilla. Kjo praktikë e sjell këtë rezultat ku ne sot duhet me dal me shfuqizuar vendime për shkak se janë shkel procedurat ligjore sipas ministrisë atje. Unë jam i bindur që edhe drejtori e ka ditë që po shkelen këto procedura. Sot kemi edhe një vendim tjetër që duhet me shfuqizuar dhe normal ne nuk mund t'ia lëmë barrë komunës dhe duhet me shfuqizuar. Unë i bëj thirrje secilit drejtor, secilit asambleist, secilit që merret me politikë këtu që më shumë të hargjojmë energji duke marrë vendime të drejta se sa duke bërë propagandë për me kthyer në efekte elektorale.

Armend Krasniqi - Drejtoria e Pronës dhe Katastrit çdo procedurë që e nis, e nis për interesa puro qytetare. Ky vendim i cili është kthyer nga ministria, unë nuk kam pas informatë sepse apsolutisht ka qenë vendim i gabuar nga ministria në bashkëpunim me akterët kryesor të cilët kanë bashkëpunuar me komunë për shkak se prona ka qenë e publikuar në listën për dhënie në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës mirëpo kjo pronë gjatë procedurës së ndarjeve ka marrë një numër tjetër dhe për këtë nuk kam qenë i njoftuar, nuk kam qenë i konsultuar.

Urim Suka - përpara fjalës që ju po thoni, unë zgjedh me i besu atyre që kanë ardhë si vendime, letrave. Të lutem vërejtjet merri si këshilla. Nuk mundesh ti me ma sjell çdo Asamble, si sot që tentove një lëndë me ma lënë. Nuk mundemi ne me votu ashtu.

Labinot Halitjaha - si PDK e si LDK e AAK ka 20 vjet që keni lënë shumë procedura pa kryer. Armend Krasniqi është drejtor i cili ka kryer procedura, që 20 vite i keni lënë bashkë. I ka heq prej banesave njerëz që as nuk i keni marrë të holla dhe i keni lënë në banesa, pronë të komunës që 20 vjet. Është Armend Krasniqi që ka marrë vendim, që stacioni i autobusave ka kalu në pronë komunale. Që 20 vite nuk i keni marrë ju bashkarisht vendimet. Është ndoshta kjo gjë e ngutshme dhe politike sepse Urimi gjithmonë kur do me bërë politik, del këtu për facebook. Nuk është mirë vetëm me sulmu. Unë e di që shumë herë ka sjell procedura ma të ngutshme por nganjëherë është e nevojshme edhe për qytetarin, edhe për biznesin dhe për komunën.

Kryesuesi - është e vërtetë ajo që tha drejtori për punën që ka bërë Armendi, disa prej punëve më të mëdhaja dhe më jetike për Komunën. Ndoshta rrjedh ndonjë lëshim por është ndër drejtorat që ka punu. Sa i përket pikës, na ka ardhë një rekomandim nga ministria dhe ne e kemi obligim që brenda afatit ligjor prej 30 ditësh ta sjellim në Asamble dhe ta shqyrtojmë.

Alban Berisha - është e vërtetë që punë janë bërë sepse edhe për atë jeni aty. Po thua drejtor që po bëjmë politikë, por përfaqësues politikë jemi dhe normal politikat ne mendojmë që po i bëjmë për interesa të qytetarëve por megjithatë është një organ tjetër që e vlerëson se a e kemi bërë politikën për interes të qytetarëve apo për interes personal por megjithatë e mira e demokracisë është që e kemi të drejtën me mendu ndryshe-ndryshe. Kurse për drejtorin ne në shumë situata edhe i kemi dhënë mbështetje sepse është një drejtor i ndieshme dhe ka probleme të gjeneruara prej pushtuesve dhe ka me shku kohë deri sa të zgjidhen këto. Vërejtjet tona gjithmonë kanë qenë që pse po marrim veprime që nganjëherë po duhet m'u kthyer sepse jemi dëshmitar që gati çdo seancë vinë vendime shfuqizuese. Njëherë prej seancave kam thënë që arroganca e numrave nganjëherë është shumë e keqe. Armendi e arsyetoi që është një gabim prej ministrisë, dhe kur është një gabim teknik që ne e kemi paraqit dhe ata nuk e kanë pa, nuk ka nevojë m'u mbledh një Asamble por ia dërgon vërejtjen ku edhe ekziston linja e komunikimit. Pavarësisht komunikimit jo të mirë mes zyrrave tuaja, mua nuk më gëzon fakti që nuk keni komunikim sepse nuk më duhet mua e asnjërit prej kolegëve e as juve nuk ju duhet mungesa e komunikimit dhe me pas humbje komuna sepse çdo humbje është humbje e qytetarëve. Drejtor është e rëndë që po e përdor fjalën që ne i kemi humb qindra e mijëra euro për shkak të komunikimit të ministrisë me dikënd akter brenda dhe më shqetëson ky fakt. Atëherë ti si përfaqësues është mirë me ndërmarrë masa ligjore në këtë drejtim. Para ligjit jemi betu që këto padrejtësi kemi m'i vendos para ligjit dhe nuk i gëzohem faktit me dal. Qëllimi jonë si parti dhe i krejt partive është me i fitu zgjedhjet por ne nuk dojmë me i fitu zgjedhjet në fatkeqësi dhe në kriminalitet.

Armend Krasniqi - inicimi i kësaj procedure të cilën e ka inicuar drejtoria jonë nuk ka pas edhe një matematikë të vogël siç e elaboron Urimi. Çdo pikë që e kam sjell deri më sot apsolutisht jam shumë i përgjegjshëm dhe e kam sjell vetëm për interesa qytetare. Mirëpo vendimi që është kthyer ka qenë komplet i gabueshëm nga ministria, mirëpo kur ka ardhë në komunë ajo ka qenë dasht me ardhë te unë.

Alban Berisha - drejtor a dyshon që është politike kjo punë, neglizhenca dhe mosadresimi?

Armend Krasniqi - nuk ka lidhje me politikë por ka lidhje me mosdije.

Kryesuesi - në materialin që iu kemi dërgu juve, edhe ju e keni këtë shkresë dhe unë e kam obligim ligjor që brenda afatit 30 ditë me sjell në Asamble shkresën e ministrisë që na ka rekomandu me shqyrtu këtë vendim dhe pikërisht shënon që nuk është në listën për dhënie në shfrytëzim dhe nuk ka asgjë tjetër.

Urim Suka - pas fjalëve që tha drejtori la me kuptu që ne jemi duke e bërë vlerësimin 4 vjeçar të drejtorit. Shumicën e vendimeve që i ka sjell drejtori ne i kemi miratu dhe në shumë fjalë të mia e kam thënë edhe superlativ. Unë sot fola për vendimin konkret.

Saranda Bajraktari - kjo pronë a është në listën e pritjes apo është çështje e gabimit teknik të parcelës? Nëse sipas jush është gabim teknik, pse ju si zyrtar ligjor që keni edhe në komunë dhe në drejtorinë tuaj, nuk komunikoni? Jemi lodh, një seancë fuqizo, një seancë shfuqizo. E admiroj punën tuaj por në këtë rast duhet me pas një komunikim brenda drejtorisë specifike.

Armend Krasniqi - parcela realisht nuk është e publikuar mirëpo ndarjen që e kemi bërë prej parcelës bazë ka qenë e publikuar.

Visar Kuçi - drejtori plotëson Drejtorin e Pronës me sqarime dhe kërkon nga të pranishmit që ta shtyejnë çështjen përpara.

Kryesuesi - kjo konsiderohet si parcellë e re dhe në bazë të kësaj ministria e ka kthyer në rishqyrtim dhe ky vendim duhet të shfuqizohet.

Visar Kuçi - nëse listat e parcelave publikohen në dhjetor dhe publikohet lista e parcelës me numrin 10 dhe kjo listë në muajin shkurt e merr edhe një numër tjetër, është mirë me ia sqaruar ministrisë dhe besoj se zgjidhet.

Armend Krasniqi - DPJK i ka kryer një tridhjetmijë lëndë sa jam unë drejtor dhe vetëm tri lëndë janë kthyer për shkak të moskomunikimit, mosqartësimin dhe mosdijeve të cilat i kanë njerëzit, qoftë në ministri dhe qoftë edhe me neve që diskutojnë.

Shefket Kolgeci - unë e konsideroj drejtorin si më të suksesshmin në qeverinë aktuale mirëpo ne sot diskutojmë për këtë pikë të rendit të ditës. Shumë herë na kanë ardhë vendime me i shfuqizu dhe atëherë kemi thënë ti shikoni mirë vendimet se mos po i kthen ministria. Në këtë rast nuk paska faj drejtori dhe drejtori i Financave qohet dhe e mbron Drejtori e Pronës, që s'ka nevojë. Këtu po i vie era fushatë.

Dardan Berisha - në bazë të asaj që është diskutu, a ka mundësi ta shtyejmë në një seancë tjetër këtë pikë?

Kryesuesi - e kemi obligim me shfuqizu brenda 30 ditësh. Nëse drejtori arrin me i bind atje, e sjell në seancën tjetër si pikë të rregullt.

Urim Suka - nëse ne e shfuqizojmë, e kthejmë në pikën zero. Nëse shqetësimet e drejtorit janë të qarta dhe ka bazë, ndoshta është mirë mos me shfuqizu dhe me komunikuar me ministrinë.

Dardan Berisha - ministria kur e kthyer emailin, a nuk keni komunikuar fare me drejtorin ju? Ti si Kryesues e ke sjell pikën menjëherë me shfuqizu. A është dasht ti me ia kthyer atë arsyetimin ministrisë?

Kryesuesi - ministria kur e ka rishqyrtu aktin, na kanë dhënë rekomandim 30 ditë dhe ne e kemi sjell për shfuqizim. Nëse arrin marrëveshje drejtori, e sjellim seancën tjetër. E hedh në votim pikën 6.

20 vota për, Miratohet pika 6

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës 01-Nr-553-27510;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Alban Berisha - nuk e mora fjalën për rastin konkret dhe normalisht jam po. Fatkeqësisht po ndodh shpesh dhe shpresoj që mos të ndodh në njerëz. E di që nuk ka ndonjë rregullore specifike që e rregullon këtë por të paktën me kriju një komision. Të gjithë e meritojnë që kanë marrë por ndoshta ka me pas ndonjë rast që ka shumë pak dëm dhe kjo bëhet rregull me ia dhënë nga 5.000 € krejtve. Por ndoshta dikush ka nevojë edhe më shumë. Nuk dyshoj në këto kërkesa por është mirë që dikush nga komuna me shku me verifiku dhe me na sjell një raport zyrtar.

Kryesuesi - në kuadër të DSHPE është zyrtari që merret me këtë çështje i cili ka dalë, e ka bërë një raport në bashkëpunim me policinë dhe raportin i lëndës është. Kryesuesi tutje jep sqarime.

Urim Suka - ne si LDK e mbështesim këtë vendim dhe nuk pajtohemi me i nda nga 5.000€ bllanko për secilin por është mirë të formohet një komision që e bën vlerësimin dhe ndoshta diku mundemi me i nda 2.000€ dhe dikund 10.000€,varësisht prej dëmit.Dua të ngris një shqetësim që lidhet me një zjarr që ka ndodh në shkollën teknike.A ka nevojë kuvendi komunal me i ndihmu apo si drejtori e mbulojnë atë dëm që ka ndodh?

Remzi Bajselmani - rasti që ka ndodh në shkollën teknike na ka shqetësu por fatmirësisht kanë intervenu shumë shpejt zjarrëfikësit.Punën është duke e kryer një firmë nga Prishtina dhe prej aty ka rrjedh zjarri.Është duke u bërë një raport prej ekspertëve dhe policisë i cili ende nuk ka dal.Shkaktarë janë punëtorët e kompanisë dhe konsiderojmë se ata do ta kryejnë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 7.

Unanimisht Miratohet pika 7.

Pika 8 shtesë

Selman Kolgeci - duke marrë parasysh rolin thelbësor dhe të pazëvendësueshëm që kanë pjestarët e policisë së Kosovës dhe FSK-së në ruajtjen e rendit,sigurisë dhe mbrojtjes së qytetarëve dhe shtetit tonë,ata janë aty kur ne kemi nevojë,në rrugë,në raste emergjente,në mbrojtje të kufijve,në shërbim të paqes dhe sigurisë sonë kolektive.Ata janë të parët që përballen me rrezikun,shpesh pa pyetur për vështirësitë apo sakrificat personale që ju sjell kjo punë.Në shenjë mirënjohje të thellë dhe me bindjen se mbështetja jonë nuk do të mbetet vetëm fjalë, propozoj që Kuvendi Komunal i Suharekës të miratoj një vendim për lirim nga pagesa për të gjithë shërbimet shëndetësore publike në institucionet shëndetësore nën menaxhimin e Komunës së Suharekës për të gjithë pjestarët e policisë së Kosovës dhe FSK-së si dhe familjeve të tyre të ngushta me vendbanim në komunën tonë.Një kategori afërsisht e njejtë për nga ekspozimi i rrezikut,ajo e zjarrëfikësve, tani më me vendim të Asamblesë janë të liruar së bashku me anëtarët e vet të familjes nga këto taksa dhe le të shpresojmë që në një të ardhme të afërt kjo lloj e pagesave të hiqet për të gjithë qytetarët tonë por pa u ndier pesha financiare në drejtorinë përkatëse.Ju ftoj të gjithëve ta mbështesni këtë vendim.

Mimoza Bajraktari - kërkesa e Selmanit është shumë e qëlluar por nuk e di sa do të jetë e mundshme të zbatohet për shkak se me rregulloren e re që na kanë sjell në nëntor ministria, ka shumë kategori të cilat asnjëherë nuk kanë pagu dhe tash janë fut me pagesa.Për me i liru policinë dhe familjarët jemi po,por ata duhet me posedu të paktën një kartelë që janë të gjithë anëtarët e familjes të regjistruar për shkak se direkt ballafaqohet me problem stafi.Nëse ka mundësi të paisen me kartela sepse është problematikë të lirohen.

Kryesuesi - pajtohem me ju sepse po e lidhi që çdo veteran e ka kartelën.

Mimoza Bajraktari - pikërisht te veteranët e kemi problemin ku çdo vit atyre ju duhet ta vazhdojnë kartelën.Sikur të jetë gjithëçka në rregull,pse jo.

Selman Kolgeci - ne po kërkojmë me marrë një vendim dhe çështja e kartelave dhe e identifikimit të familjes së ngushtë është procedurale dhe besoj është barrë për DSHMS por neve si kuvendar besoj na takon me i liru dhe të japim kontribut për këto dy kategori dhe ju ftoj që këtë vendim ta përkrahim.

Mimoza Bajraktari - ne e kemi të njejtin problem,stafi shëndetësor ku ne vet punojmë aty dhe detyrohemi me regjistru në protokol dhe me detyru me pagu për shkak se nuk lejon mos me pagu sepse automatikisht kërkohet kodi i pagesës në protokol.

Enver Shabani - është e vërtetë që vendimi që është përmes Asamblesë para 5 apo 6 viteve, zjarrëfikësat kanë qenë të liruar nga shërbimet primare por ka më shumë se një vit që ata kanë probleme pas kësaj rregullore së re.Drejtori tutje jep sqarime dhe thotë që në këtë kontest duhet të futen edhe ata nëse bëhet një vendim i ri.

Selman Kolgeci - ne e kemi nxjerr një tarifë për taksa dhe është çështje e organizimit të brendshëm të Drejtorisë së Shëndetësisë pse nuk e realizojnë.Kategorinë që po e përmend ti është në nenin 20 pika 1.21 ku lirohen edhe zjarrëfikësit dhe për atë nuk e kam fut në këtë kategori sepse janë kategori e njejtë.Mendoj që duhet të na jep sqarime edhe zyrtari ligjor dhe mendoj që nëse ekziston një rregullore,ajo duhet të zbatohet.Duhet me kërku sqarime prej drejtoreshës se pse nuk po zbatohet.A ka ndonjë kundërthënie mes rregullore që ka ardhë prej ministrisë dhe rregullore për taksa dhe tarifa që ka nxjerr kuvendi jonë.

Mimoza Bajraktari - Kam një kërkesë. Ka edhe shumë kategori tjera që duhet të futen dhe ndoshta është mirë që seancën tjetër ta shqyrtojmë dhe ta votojmë.

Shefket Kolgeci - e jona është ta votojmë këtë projekt-vendim dhe a zbaton qendra, është kompetencë e dikujt tjetër. Apeloj ta votojmë.

Saranda Bajraktari - të përgëzoj për iniciativën por a ka bisedu me institucionet e policisë që a munden të paisen me kartela policia për vet faktin që po thua që duhet me u liru edhe familjarët e tyre, sepse pajtohem me Mimozen që ekziston çështja administrative që i penalizon në mungesë të kartelave. Do të ishte mirë të futen edhe mësimdhënësit. Me shumë kënaqësi e votojmë komplet.

Selman Kolgeci - një vendim i ngjashëm është duke u apliku në Prishtinë dhe para 2-3 muajve është miratru në komunën e Gjilanit. Sindikata e policisë ka fillu bisedimet që në gjithë komunat me bë një marrëveshje të tillë. Besoj ata janë të përgaditur për këtë por edhe është e lehtë në E-Kosova me i pa se kush janë anëtarët e ngushtë të familjes.

Avni Bytyqi - rregullorja që është miratu nga Kuvendi në vitin 2023 ka qenë në rregull për arsye se e ka marrë ligjshmërinë nga minisatria e linjës. Nga muaji tetor-nëntor i vitit 2024 ministria e ka shfuqizuar atë udhëzim dhe e ka nxerr një rregullore të re. Ky udhëzim nuk e parasheh të lirohet kategoria e policisë, zjarrëfikësve dhe të FSK-së dhe disa kategori tjera por ka përfshi shumë kategori tjera të cilat nuk kanë qenë të përfshira në udhëzimin e kaluar. Çështja e bashkëpagesave në QMF dhe QKMF është e hyrë vetanake e komunës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, neni 2 i jep kompetencë dhe autoritet Kuvendit që ti menaxhon në mënyrën më të mirë të mundshme dhe sipas kërkesave dhe nevojave të qytetarit, të hyrat vetanake që vijnë nga pashkëpagesat e qytetarëve. Në këtë rast i jep kompetencë dhe autoritet Kuvendit që të merr vendim, të cakton tarifa dhe ti liron kategoritë për të cilat vlerëson. Në një vendim të tillë e kemi marrë për zjarrëfikësat dhe për mamografinë dhe e kemi marrë konfirmimin e ligjshmërisë. Besoj që edhe ky vendim që merret sot është i ligjshëm.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 8.

Unanimisht Miratohet

Pika 9. Pyetje dhe përgjigje;

Qëndrim Elshani - siç e dimë, komuna e Suharekës nuk ka apliku fare për banimin e përballueshëm dhe social edhe pse kjo është një mundësi e mirë për qiftet e reja dhe për familjet që i kanë të ardhurat e ulëta. Pasi Kryetari nuk është, pres përgjigje seancën e radhës. Pse komuna e Suharekës nuk ka apliku për banimin e përballueshëm? A është arsyeja që po i ndihmon shokëve të vet dhe pse po e vendos interesin e tyre para interesit qytetar?

Elmaze Bytyqi - Çfarë masa ka marrë Drejtoria e Bujqësisë pasi shumë fermerë janë ankuar që komuna ende nuk ka caktuar një lokacion për asgjësimin e kafshëve të infektuara me sëmundje të ndryshme dhe si pasojë e saj shumë fermerë janë të detyruar që kafshët e sëmuta ti mbajnë në të njëjtin vend me ato të pa sëmura.

Ardian Kotorri - ne e kemi një shqetësim të madh sepse kur është bë PZHK dhe HZK nuk është planifiku një lokacion ekzaktë për këtë punë por megjithatë unë me drejtorin e Urbanizmit e kemi diskutu këtë çështje dhe jemi duke gjet modalitetet dhe një lokacion për me pa mundësinë për ta përcaktu. Do ta marrë seriozisht sepse është problem i madh.

Liridon Fandaj - kam një shqetësim për shkak se në Asamble as ekzekutivi por as asambleistat e ekzekutivit nuk po qëndrojnë deri në fund. Kërkesa ime ka qenë disa herë që pikën pyetje dhe përgjigje ta vendosim të dytën pas procesverbalit por asnjëherë nuk është përfill. Pyetje për Drejtorin e Financave: Pas një kërkesë që unë kam bë për obligimet e personave juridik dhe fizikë të rentës dhe qerasë për pronat publike, përgjigja është kthyer zyryarisht dhe aty shihet që janë borgje të trashëguara, afërsisht 769.000€. Cilat janë masat që i ka marrë drejtoria dhe a ka një plan se si do ti inkasojë këto borgje? Shqetësuese është që në mesin e atyre që kanë obligime, ata vazhdojnë ta shfrytëzojnë pronën publike. Pyetje për Drejtorin e Urbanizmit: në vitin 2024 bashkë me zv. Drejtorin e QKMF-së kanë shku me një udhëtim në Amerikë në lutjet e mëngjesit. Cili është përfitimi i komunës? Pyetje për Drejtorin e

DSHPE: kam një shqetësim qytetar në rrugën Harea në fshatin Maqitevë ku një mur që ka qenë aty, është rrëzu dhe është rrezik për qytetarët. Cilat janë masat që si komunë mundeni me i marrë? I keni bërë publike në faqe të komunës dëgjimet publike por ne si asambleist nuk kemi kornizë afatmesme që me ardhë edhe ne në dëgjime publike. Pse nuk po marrin pjesë qytetarët nëpër dëgjime, konkretisht në Peqan? Nuk marrin pjesë sepse asnjë prej atyre që kanë kërku nuk e keni inkorporu dhe jeni marrë vetëm me kryesi. Pyetje për Drejtorin DKA-së: në sa shkolla ka ushtrues detyre? A është duke e shkel ligjin drejtori i DKA-së që i mban si ushtrues detyre disa drejtorë në disa shkolla që dy vite?

Nënkryetarja - sot me arsye nuk është Kryetari dhe të gjitha asambleiste, për arsye se kemi 6 aktivitete.

Liridon Fandaj - të falemderoj për pjesëmarrjen nënkryetare edhe në KPF sepse Kryetari ka qenë i papërgjegjshëm edhe në KPF por nuk është hera e parë që po ndodh kjo.

Nënkryetarja - sa i përket banimit social ne e kemi pas një projekt nga viti 2019 së bashku me MAPL. Komuna ka nda parcelë ndërsa investimet i bën MAPL-ja. Ne kemi qenë të gatshëm dhe ka nevojë sepse ne ka disa vite që paguajmë qera në mungesë të një banimi social. Ky projekt është ndërpre dhe jo për shkak të komunës.

Enver Shabani - është e vërtetë që përmes emailit ka ardhë një ofertë ose kërkesë nga ministria për të aplikuar dhe aty kanë pas me përfitu vetëm 6 komuna dhe ne e kemi pa që nuk mundemi me fitu dhe nuk kemi vazhdu. Drejtori tutje jep sqarime dhe thotë që nuk kemi apliku sepse shumicën e problemeve të banimit social i kemi zgjedh me jetimat e ballkanit me bashkfinancim.

Qëndrim Elshani - 13 komuna kanë përfitu me të drejtë. Ka shumë investime të qeverisë në Suharekë dhe është shumë gabim me mendu që nuk e fitoj. Ne duhet të aplikojmë.

Labinot Halitjaha - është shqetësim puna e borgjeve komunale sikurse puna e shfrytëzimit të pronave komunale dhe tatimit në pronë. Ka pas rritje të vazhdueshme të borgjeve. Unë si drejtor kur kam ardhë në vitin e parë, i kam pa se si rrejdhin gjërat në komunë dhe vitin e dytë kemi pas me i dërgu në përmbartim të gjitha borgjet komunale, fjala është për shfrytëzimin e pronës dhe dhe përmbartuesit kanë kërku për qindje direkte nëse ti e dërgon në përmbartim. Komuna nuk ka planifiku mjete për procedurat përmbartimore. Vitin tjetër oda e përmbartuesve ka ndryshu rregulloren dhe ka kërku që çdo lëndë që vje duhet të sillet me pagë 1 € dhe vazhdojnë procedurat pasi të rrjedhin mjetet. Ne i kemi ndjek të gjitha procedurat ku një procedurë merr 180 ditë, me tri vërejtje. Unë i kam të gjitha procedurat me të gjitha vërejtjet dhe kur e kam marrë vendimin me qu lëndën në odën e përmbartuesve, më kanë thënë që në gusht të viti 2024 ka ndryshu një rregullore ku thotë që të gjitha kontrat duhet të jenë të vërtetuara te noteri për të vazhdu procedurën përmbartimore. Drejtori tutje jep sqarime. Për pjesën tre vjeqare kemi me diskutu me zyrën ligjore se a vazhdojmë me pjesë përmbartimore apo me gjykatë. Për pjesën e tatimit në pronë që janë borgjet komunale, na ka dërgu ministria një email që do të mirren së bashku me administratën tatimore dhe do ti vjelin borgjet.

Liridon Fandaj - kërkoj nga zyrtari ligjor se a keni kundërshtu këtë pjesën e përmbartuesve. Nuk e di që duhet me dërgu te noteri një kontratë komunale sepse ai është institucion. Unë i kam kërku qeratë çka kanë në shfrytëzim dhe është ajo vlerë, jo tatimit në pronë. Është shqetësim që një njeri me 65.000€ borgj vazhdon vjel taksat e qytetarëve në Suharekë ku edhe lokacioni ka ndërru.

Avni Bytyqi - siq e përmendi drejtori, Oda e avokatëve ka nxerr një rregullore të brendshme dhe të gjitha procedurat e përmbartimit që shkojnë nga insitucionet, duhet të shkohet përmes Odës së përmbartuesve dhe Oda e përmbartuesve i shpërndan lëndët nëpër përmbartues me qëllim që një përmbartues mos ti ekzekutojë të gjitha lëndët. Në vitin 2024 ka bërë plotësim-ndryshimin e ligjit për përmbartim dhe aty një dispozitë ligjore thotë që aktet administrative nuk janë të përmbartueshme dhe drejtoria në këtë rast duhet që këto akte ti shëndrro në fatura dhe t'ju dërgojnë të gjithë borgjlinjëve që kanë obligime në komunë për pronën që po e shfrytëzojnë dhe tek atëherë faturat ti dëgojnë tek përmbartuesit për ekzekutim dhe përmbartim.

Visar Kuçi - ishte pyetja për Amerikë. Ende nuk përfitojnë por në të ardhmen do të përfitojnë qytetarët.

Enver Shabani - sa i përket rrugës Harea në Maqitevë, ne si drejtori nuk kemi një informatë që ka një mur të rrënuar por ne kemi një kontratë të hapur për sanimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale. Do ta verifikojmë dhe do ti shohim masat që mund ti marrim. Sa i përket qarkores ne jemi në ekip të caktuar për dëgjime publike me qytetarë dhe jemi nda në dy grupe. Ne i ftojmë qytetarët në të gjitha format që

përmendën kolegët. Është e vërtetë që në fshatin tuaj kanë ardhë vetëm dy qytetarë për të dëgjuar dëgjimin publik dhe ndoshta është mosinformim ose mos interesim.

Liridon Fandaj - te muri në Maqitevë kam marrë informata dhe kam foto që ai mur është rrënu për shkak të kushteve atmosferike dhe është mirë ta vizitoni sepse është rrezik për qytetarët. Te pjesa e dëgjimeve publike, ti ke qenë në fshatim tim në dëgjime publike më herët dhe jam i vetmi prej asambleistave që kam marrë pjesë jo vetëm në fshatin tim por edhe në fshatra tjera dhe në fshatin tim ato që kanë kërku qytetarët nuk janë inkorporu.

Kryesuesi - Drejtori i Arsimit nuk është prezent por shqetësimin ia përcjelli.

Liridon Fandaj - në shkollën e Samdraxhës vazhdon me një ushtrues detyre edhe pse është ditë që drejtori ka me dal në pension dhe është dasht me shpall konkursin. Gjithëashtu edhe në Sllapuzhan dhe gjimnaz njejtë vazhdon me ushtrues detyre.

Urim Suka - unë kam bërë dy pyetje muajin e kaluar, një për Drejtorinë e Bujqësisë dhe një për Drejtorinë e Administratës por nuk kam marrë përgjigje. Pyetje për Drejtorin DSHPE: kam marrë një shqetësim që në vitin 2021 ju keni marrë një kërkesë me shkrim nga Xhevat Gashi për ndërtimin e një muri mbrojtës në fshatin Luzhnicë i cili ishte dëmtu si pasojë e reshjeve të shumta dhe vërshimeve të asaj kohe. Kësaj kërkesë iu keni përgjigj pozitivisht në bazë të shkresës që pashë por keni thënë që, në momentin që krijohet një mundësi buxhetore e rregullojmë. Unë isha në fshat dhe pashë gjendjen atje ku shihej qartë që nga kjo shembje rrezikohej edhe përfundimi i ndonjë makine në shtëpinë e qytetarit, madje një pjesë e murit po mbahej edhe me shtylla betoni e cila rrezikon të shembet dhe si pasojë mund ti rrezikoj edhe fëmijët që janë aty. A ka mundësi që ky problem të zgjidhet brenda këtij viti apo qytetarët duhet të vazhdojnë të përballen me rrezikun potencial? Pyetje për Drejtorin e Bujqësisë: me datat 6,7 dhe 8 prill kemi pas reshje të borës dhe ngrica ku për pasojë kemi pas dëme të konsiderueshme në këto kultura bujqësore: të gjitha pemët bërthamore, si kumbulla, kajsi, qershi, pjeshkë si dhe arrrat janë dëmtu 100%. A jeni në dijeni për këto dëme? A keni komision në nivel komunal për vlerësimin e dëmeve? Nëse po, kërkoj nga ju që sa më shpejt të bëni vlerësimin e këtyre dëmeve dhe t'u dilni në ndihmë këtyre fermerëve sipas mundësive buxhetore të komunës por edhe të kërkon mbështetje nga ministria. Së fundmi jam njoftu që komuna e Rahovecit ka fillu me iu dal në ndihmë fermerëve për këto dëme.

Enver Shabani - është e vërtetë që në vitin 2021 paska ardhë një kërkesë dhe ne e kemi obligim ligjor që ti përmbahemi në shumicën e rasteve dhe i kthjemë një përgjigje me shkrim. Kryesisht përgjegjën e përpilojmë ashtu si thatë, varësisht nga mundësitë buxhetore, kur themi kështu, ne shpesh besojmë në donacione. Ju e dini që komuna deri në vitin 2021 ka pas një fond emergjent dhe nuk ka më fond emergjent sepse ministria e ka heq si kod. Ne sigurisht nuk kemi pas mundësi buxhetore për me mbulu këtë dëm. Ne duhet patjetër me shku me marrë masa por ende nuk ka bërë kërkesë me shkrim sepse kërkesat na detyrojnë me dal në teren. Nuk besoj që kryhet këtë vit sepse ka dal nga sistemi dhe që nga viti 2021 nuk besoj që kthehem prapa.

Urim Suka - ju më parë thatë që e keni një kontratë që mund të intervenoni në Maqitevë. Ju ndoshta e keni harru si ngjarje por ju duhet me dërgu ekipin me vlerësu dhe si ta vlerësoni ndihmoni. Nëse ka mundësi buxhetore ndoshta është mirë me trajtu.

Enver Shabani - ne do ta verifikojmë dhe nëse rrezikohet rruga publike, ne brenda mundësive do të mundohemi me marrë masa. Drejtori tutje jep sqarime.

Ardian Kotorri - Urimin po e riinformojë për shkak që Urimi e din që komuna e Suharekës nuk ka fonde emergjente dhe asnjë komunë. Tha që komuna e Rahovecit i ka kompenzu por nuk është e vërtetë. Prej vitit 2023 Ministria e Bujqësisë nuk e bën kompenzimin e dëmeve për shkak se tash e tutje është një partneritet publiko-privat, vetëm kush i ka të siguruara. Ndërsa për dëmet tjera, ka pas dëme mirëpo kemi qenë me një fazë të aplikimit të subencioneve ku aplikojnë deri 1500 fermer dhe jemi të penalizuar në punë tjera. Nga e hëna jemi më të lirë dhe të shohim çka do të mund të bëjmë. Drejtori tutje jep sqarime.

Urim Suka - unë thash që kanë fillu me bërë vlerësimin e dëmeve Rahoveci. Dëmi është real dhe për komunën është shqetësim. Duhet të dilni ta vlerësoni dëmin dhe atë vlerësim që e bëni me adresu në ministri dhe me pa cila është mundësia jote si komunë.

Selman Kolgeci - Kam pyetje për Drejtorin e DKA-së: kam informacione që në gjimnazin „Jeta e Re“ 50 profesor sa janë të angazhuar, 25 prej tyre kanë me pas gjysmë norme e 12 prej tyre kanë me pas 0 orë. Kjo

është për shkak numrit të ulët të nxënësve dhe sipas informacioneve ka mundësi m'u nda në klasa me më shumë paralele në mënyrë që mos m'i lënë mësimdhënësat pa angazhim. Shpresoj që drejtori të intervenojë në këtë drejtim që mësimdhënësat mos të mbesin pa normë. Pyetje për Drejtorin e DSHPE: kam pa shumë tabela të komunikacionit nëpër rrugë, çoftë udhëregues, çoftë emra të rrugëve dhe është një ndjenjë jo e mirë që me pa emra të dëshmorëve për toke. Kërkoj që me gjet një formë dhe me dal me i sanu këto.

Enver Shabani - është vërejtje me vend. Besoj dhe shpresoj, që nga 1 qershori NPL „Eko Theranda“ do ti merr përsipër këto punë, disa punë të vogla që kompanitë e mëdhaja kanë hezitu m'i kry.

Bulëza Kuçi - kam një kërkesë, është fjala për pjesën të Raifaizen Banka në Suharekë. Në atë pjesë ka nevojë për vija të bardha në trotuar. Pjesa tjetër e qytetit rregullohet, mbillen lule ndërsa ajo pjesë është e neglizhuar. Pse? dhe si kërkesë do të ishte mirë dhe e nevojshme të investohet në rregullimin vijave në parkingje.

Visar Kuçi - si kërkesë ende nuk e kemi marrë. Besoj që e bëjmë një kontratë të shenjëzimit dhe do ta kemi parasysh.

Aziz Bytyqi - po e ngris një çështje të cilën e ka ngrit Dardan Berisha seancën e kaluar. Bëhet fjalë për rrugën Xhavit Sylja e cila është shumë e dëmtuar dhe ka vështirësi për çdo kalimtar që kalon me automjet. E di përgjigjen që e ke dhënë por dua një përgjigje më ndryshe.

Enver Shabani - edhe herën e kaluar e kemi marrë me seriozitet pyetjen sepse 99% e qytetarëve të Suharekës e frekuentojnë atë rrugë. Ju kam thënë që nuk është rrugë e jona por do ta marrim me seriozitet dhe do ta trajtojmë a kemi mundësi dhe a na lejohet.

Saranda Bajraktari - të njëjtën situatë e kemi edhe rrugën në Duhël ku i kam shenu drejtorit por nuk kam marrë ende përgjigje. Ne nuk e dim a është çështje e komunës apo e ministrisë por definitivisht po udhëtojnë çdo ditë atje. Ka raste ku tentohen për aksidente me idenë që me i mbrojtë veturat. Në situatë të tilla ata mund edhe ta padisin komunën. E dimë që ministria nuk po merr masa por nuk do të thotë që komuna mos me marrë një iniciativë të tillë për deri sa pe ka mundësi me i rregullu shumë rrugica deri në oborr.

Enver Shabani - kur përmende padinë, ka pas raste ku qytetarët e rëndomtë na kanë padit si komunë për defektet që iu kanë kriju në automjetet e tyre ku nuk ka pas puseta në rrugë por në këtë rast ajo nuk është përgjegjësi e komunës sepse është rruga e ministrisë por ne do të mundohemi qytetarëve me i dal në ndihmë kur ka mundësi. Kanalizimi në Bllacë dhe në Duhël ka fillu të sanohet.